

KONTRATË BINJAKËZIMI
Përkrahje për Statistikat

Kosovë



RAPORT MBI MISIONIN

Vazhdim i përkrahjes në zhvillimin e Strategjisë së Diseminimit

Komponenti nr 4.9.2

Misioni i udhëhequr nga
Jesper Ellemose Jensen
&
Annegrete Wulff,
Statistikat e Danimarkës

1-4 Shtator 2015

IPA 2012

Emri i autorit, adresa, e-mail

*Annegrete Wulff
Statistics Denmark
Sejrøgade 11
DK-2100 Copenhagen Ø
Denmark
Tel: +45 39173155
Email: awu@dst.dk*

*Jesper Ellemose Jensen
Statistics Denmark
Sejrøgade 11
DK-2100 Copenhagen Ø
Denmark
Tel: +45 39173244:
Email: jej@dst.dk*

Përmbledhje

Përmbledhje ekzekutive	Fejl! Bogmærke er ikke defineret.
1. Komentet e përgjithshme.....	4
2. Vlerësimi dhe rezultatet.....	4
3. Konkluzionet dhe rekomandimet	4
Aneksi 1. Termat e Referencës.....	5
Aneksi 2. Personat e takuar	Fejl! Bogmærke er ikke defineret.

Lista e Shkurtesave

ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
TeR	Termat e Referencës
GIS	Sistemi Informatave Gjeografike

1. Komentet e përgjithshme

Ky është aktiviteti i dytë në komponentin 4.9.2. Aktivitetet në komponentin 4.9 janë shtuar në projektin e binjakëzimit pas fillimit të tij dhe me kërkesë specifike nga ASK-ja. Qëllimet kryesore të 4.9 janë

- Vlerësimi i diseminimit aktual në ASK
- Harta rrugore për zhvillimin e strategjisë së diseminimit

Programi i ASK-së i statistikave zyrtare 2013-2017 thekson që duhet të zhvillohet një politikë diseminimi, përfshirë udhëzuesit për dizajnin e tabelave, grafikëve dhe për përmirësimin e webfaqes. Tashmë është punuar në kuadër të Projektit të Binjakëzimit në zhvillimin e udhëzuesve për tabelat dhe grafikët (*Shih: raportet mbi Aktivitetet 4.4.1 dhe 4.4.2 – Krijimi i udhëzuesve për dizajnin e publikimeve të printuara dhe elektronike, nga Huttunen dhe Stefansson*). Në Qershor 2015 ka pasur një aktivitet në kuadër të projektit të binjakëzimit edhe lidhur me të punuarit me shtypin dhe mediat (*4.3.3 Të punuarit me shtypin/mediat –nga Dal Petersen & Harbo Holm*). Edhe një aktivitet tjetër pritet të mbahet nga *Dal Petersen & Harbo Holm* për të ndihmuar ASK-së në finalizimin e strategjisë.

Projekti i Binjakëzimit ka për qëllim të:

- Zhvillojë një Strategji formale për diseminimin në ASK
 - Në përputhje me kërkesat Evropiane/praktikat më të mira
 - Në përputhje me legjislacionin në Kosovë
 - Që reflekton nevojat e grupeve të përdoruesve
- Zhvillojë / azhurnojë politikat e nevojshme
 - Procedurat e shkruara / udhëzuesit për procesin e diseminimit

Projekti i Binjakëzimit do të vazhdojë deri në fund të Shkurtit 2016, që do të thotë se Strategjia e Diseminimit duhet të jetë e gatshme për aprovim nga menaxhmenti i lartë i ASK-së më së voni deri në fund të Janarit 2016.

Konsulentët dëshirojnë të falenderojnë të gjithë zyrtarët dhe personat e takuar, për mbështetjen dhe informacionet e vlefshme që kanë dhënë, gjë që ka lehtësuar shumë punën e tyre gjatë qëndrimit në Kosovë.

Këndvështrimet dhe vëzhgimet e paraqitura në këtë raport janë ato të konsulentëve dhe jo domosdoshmërisht përputhen me këndvështrimet e BE-së, ASK-së apo Statistikave të Danimarkës.

2. Vlerësimi dhe rezultatet

Vazhdim i misionit 4.9.1

Gjatë aktivitetit 4.9.1 është krijuar një dokument në formë drafti për inspirim të punës së mëtejme mbi strategjinë e diseminimit. Dokumenti mbulon ambicet/udhëzuesit kryesorë, që ekzistojnë në legjislacionin e Kosovës (Ligji mbi Statistikat) dhe Kodin e Praktikës Evropiane për statistikat.

Strategjia nuk mund të qëndrojë e vetme

Nga diskutimet mes ekspertëve dhe ASK-së është bërë e qartë që formulimi i strategjisë së diseminimit NUK është problemi kryesor për sa i përket diseminimit. Strategjia duhet të jetë e mbështetur dhe e përkrahur nga një numër procedurash/udhëzuesish të shkruar, ku

përshkruhen në detaje se si stafi i ASK-së duhet të zbatojë politikën e diseminimit në baza ditore.

Një listë e procedurave/politikave të nevojshme

Gjatë misionit, është definuar një listë e politikave dhe procedurave të nevojshme. Lista paraqitet në këtë raport si Aneks 3. Lista përmban përshkrimet më bazike/të rëndësishme procedurale, për të cilat ka nevojë ASK-ja në mënyrë që të realizojë diseminimin në mënyrë efikase. Kjo do të thotë se duhet të theksohet jo vetëm ÇFARË duhet të bëhet, por po ashtu edhe KUSH (cila njësi apo individ) është përgjegjëse për ta bërë këtë. Pasi ky material është kryesisht për qëllime të brendshme, parimisht është rënë dakord që ASK ti përpilojë këto dokumente në gjuhën Shqipe. Më pas, ato do të përkthehen në gjuhën Angleze nga projekti i Binjakëzimit dhe ekspertët mund të ofrojnë komentet e tyre dhe këshillat përkatëse.

Afati kohor dhe stafi përgjegjës për iniciimin dhe formulimin e secilit dokument është i përfshirë në përmbledhjen e dokumentave. Draftet e para për të gjitha dokumentet do të nevojiten në fund të Dhjetorit 2015. Një mision (4.9.3) do të caktohet, jo më vonë se në javën e parë të Janarit 2016, për të ndihmuar ASK-në në finalizimin e dokumentave. Të gjitha politikat procedurale përkrahëse dhe strategjia e diseminimit duhet të finalizohen dhe aprovohen para përfundimit të projektit të Binjakëzimit.

Drafti i parë i strategjisë së diseminimit

Gjatë misioneve 4.9.1 dhe 4.9.2 është hartuar një draft i parë i strategjisë së diseminimit dhe është diskutuar me stafin e ASK-së. Drafti i parë paraqitet në Aneksin 4. Drafti është zhvilluar në gjuhën Angleze, por do të përkthehet në gjuhën Shqipe për ta bërë më të lehtë diskutimin dhe kontribuimin në zhvillimin e tij një grup më i madh i personave.

3. Konkluzionet dhe rekomandimet

Ky aktivitet ka treguar që nevojiten një numër dokumentesh procedurale përkrahëse për ta bërë të dobishme dhe inovative strategjinë e diseminimit për ASK. ASK është e vetëdijshme për shumë çështje praktike dhe do të përfitojë shumë nga 'kodifikimi' i procedurave të saj sa më shpejt që është e mundur.

Rekomandimi kryesor që ne mund të ofrojmë është që ASK të hartojë sa më shpejt që është e mundur dokumentet e përshkruara në Aneksin 3, sipas orarit/afatit kohor që është dakorduar gjatë këtij aktiviteti (4.9.2).

Stafi përgjegjës për hartimin e dokumentave dhe ekipi i Binjakëzimit duhet të bëjë sa më shumë që është e mundur të përfshijë sa më shumë staf të ASK-së në mënyrë që të nxitet fryma e zotërimit/pronësisë mbi dokumentet në të gjithë organizatën.

Aneksi 1. Termat e Referencës



Projekti i Binjakëzimit i BE-së
KS12 IB ST 01
Përkrahje për Statistikat

Termet e Referencës:

Komponenti 4: Sistemi i Teknologjisë Informative dhe Diseminimi

Aktiviteti 4.9.2: Përmirësimi i Diseminimit – Vazhdim i përkrahjes në zhvillimin e Strategjisë së Diseminimit

Afatet:

TeR –data e finalizimit: 18 Gusht 2015

Fillimi / fundi i aktivitetit: 1-3 Shtator 2015

Koha e raportimit: 11 Shtator 2015

Rezultatet obligative të komponentit:

Rezultatet obligative	Intervenimi logjik	Standardet	Burimet e informacionit	Supozimet

<p>Aktiviteti 4.2</p>	<p>Zhvillimi i sistemeve të TI diseminimit permes web-it</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Web faqja e ASK dhe përmirësimi i përdorimit të saj nga tremujori i 8-të i projektit • Diseminimi i databazës i instaluar dhe në dispozicion për publikun nga tremujori i 7 i projektit 	<ul style="list-style-type: none"> • Raportet Tremujore të Binjakëzimit • Raportet e Misionit 	<ul style="list-style-type: none"> • Kapacitet i mjaftueshëm i absorbimit • Numër i vogël i stafit i involvuar në implementim • Staf i punon në realizimin e detyrave, që lidhen me projektin, në mes të misioneve • Termat e Referencës të detajuara janë zhvilluar në kohën e duhur, duke detajuar detyrat, rezultatet e pritura, pjesëmarrësit e aktivitetit dhe agjendën
----------------------------------	---	--	---	--

Subjekti / qëllimi i aktivitetit: 4.9.2

Zhvillimi i strategjisë së diseminimit për ASK-në

Rezultatet e pritura nga aktiviteti 4.9.2

- Vlerësimi i diseminimit aktual në ASK
- Hartimi për Strategjinë e Diseminimit

Ky mision është vazhdim i aktivitetit 4.9.1, që është mbajtur në Maj 2015.

Në misionin e mëparshëm është diskutuar gjendja e politikës së diseminimit në ASK dhe është hartuar një orar për implementimin e një politike të re diseminimi.

Raporti nga aktiviteti 4.9.1 ka deklaruar që:

Bazuar në diskutimet tona, mund të paraqesim disa prej rekomandimeve të përgjithshme fillestare. Së paku një aktivitet shtesë do të mbahet për këtë çështje. Raporti mbi këtë aktivitet do të paraqesë rekomandimet kryesore. Gjatë aktivitetit të radhës do të diskutohet po ashtu për iniciativat relevante strategjike, që të adresohen brenda periudhës aktuale të planifikuar nga ASK-ja.

- ASK duhet të hartojë politikën e diseminimit bazuar në pritshmëritë e Kodit të Praktikës
- ASK duhet t'i ketë politikat në përputhje me legjislacionin e Kosovës
- Drafti i politikës duhet të jetë i gatshëm sa më shpejt që është e mundur – preferohet Qershor/Korrik
- Drafti duhet të diskutohet dhe të aprovohet nga menaxhmenti i lartë

- Drafti i politikës duhet të finalizohet së bashku me ekspertët në fund të Gushtit/fillim të Shtatorit
- Zhvillimi i politikës/procedurave të brendshme për trajtimin e gabimeve
- Zhvillimi i politikës/procedurave të brendshme për të gjithë hapat e procesit të publikimit
- Vendosja e një kohe fikse dhe të saktë për publikimin e statistikave
- Afatet kohore dhe përpikëria duhet të analizohen dhe prezantohen sistematikisht, të raportohen te menaxhmenti i lartë dhe të bëhen publike

Programi i statistikave zyrtare 2013-2017 i ASK-së deklaroi që duhet të hartohet një politikë e diseminimit, përfshirë udhëzuesit për dizajnin e tabelave, grafikëve dhe për përmirësimin e webfaqes. Kjo është diskutuar më tej në takimin e Këshillit Drejtues të Binjakëzimit. Kërkesa është parashtruar nga kryeshefi ekzekutiv dhe ky aktivitet është aprovuar dhe përfshirë në programin e Binjakëzimit.

Aneksi 4 i raportit të misionit 4.9.1 përmban një numër titujsh për politikën e diseminimit. Para misionit 4.9.2, ASK duhet të punojë më tej rreth këtyre titujve. Gjatë misionit 4.9.2 ASK dhe ekspertët do të zhvillojnë edhe më tej titujt dhe diskutojnë se çfarë është e mundur dhe çfarë jo.

Aktiviteti 4.3.3 (Dahl Petersen & Harbo Holm) në Qershor ka adresuar çështjet në lidhje me punën e ASK-së me shtypin dhe mediat – rezultatet nga ky aktivitet po ashtu duhet të përfshihen në strategjinë e diseminimit.

Nëse premtori koha gjatë misionit 4.9.2, ekspertët së bashku me ASK-në do të fillojnë zhvillimin/hartimin e disa politikave/procedurave të brendshme, që mbështesin strategjinë.

Stafi i ASK-së:

1. Ilir Berisha, Drejtor i DSELLK, ASK, Ilir.t.Berisha@rks-gov.net
2. Ramiz Ulaj, Drejtor i DMTI, ramiz.ulaj@rks-gov.net
3. Bekim Canolli, Shef i Divizionit të Metodologjisë, Bekim.canolli@rks-gov.net
4. Znj. Arta Salihu, Kordinatorë në ASK, arta.salihu.morina@rks-gov.net
5. Teuta Zyberi, Zyrtare e Lartë për Marrëdhënie me Jashtë, teuta.zyberi@rks-gov.net
6. Znj. Hazbije Qeriqi, Zyrtare për Komunikim, ASK, hazbije.qeriqi@rks-gov.net
7. Znj. Drita Sylejmani, Zyrtare e Diseminimit, Drita.sylejmani@rks-gov.net,
8. Znj. Shqipe Gashi, Zyrtare e Diseminimit, ASK shqipe.gashi@rks-gov.net
9. Z. Burim Limolli, Shef i TI-së - Divizioni, burim.limolli@rks-gov.net
10. Z. Haki Kurti, Shef i Divizionit të Ambientit, ASK, Haki.Kurti@rks-gov.net
11. Znj. Flutura Shosholli, Zyrtare për ambient, ASK, Flutura.Shosholli@rks-gov.net
12. Znj. Bedrije Demaj, Zyrtare LFS, ASK Bedrije.Demaj@rks-gov.net,
13. Z. Hydai Morina, Zyrtare e HBS, ASK Hydai.Morina@rks-gov.net

Ekipi i Projektit të Binjakëzimit i ASK-së:

Udhëheqës i Projektit në ASK, Z. Ilir T. Berisha, Drejtor i Statistikave Ekonomike dhe Llogarive Kombëtare, Ilir.T.Berisha@rks-gov.net
Homologu i RTA, Znj. Teuta Zyberi, Zyrtare e Lartë për Marrëdhënie me Jashtë, teuta.zyberi@rks-gov.net

Ekspertët e vendeve anëtare:

Znj. Annegrete Wulff, Shef i Divizionit, Statistikat e Danimarkës, awu@dst.dk
Z. Jesper Ellemose Jensen, Këshilltar i lartë, Statistikat e Danimarkës, jej@dst.dk

Stafi i Projektit të Binjakëzimit:

Z. Per Knudsen, RTA, pkn@dst.dk
Znj. Nora Zogaj, asistente e RTA, nzogaj@yahoo.com

Historiku

Në përgjithësi aktivitetet në komponentin 4 do të adresojnë këto çështje:

- Përmirësimi i diseminimit përmes web faqes i statistikave të caktuara, duke përfshirë përmirësimin e webfaqes së ASK-së dhe duke e bërë atë më të lehtë për ta përdorur dhe mjet më fleksibil diseminimi;
- Zhvillimi i udhëzuesve për dizajnimin e tabelave dhe grafikëve, që po ashtu të përdoren për diseminim përmes webfaqes;
- Zhvillimi i databazës së diseminimit, përfshirë metadata më të kompletuara që mbulojnë aspekte të ndryshme, që lidhen me cilësinë e të dhënave;
- Përmirësimi i komunikimit të drejtpërdrejtë me përdoruesit
- Prezantimi i Kodit të Praktikës, aspekti i diseminimit
- Zhvillimi i strategjisë së diseminimit

Aktivitetet që duhet të ndërmerren si parapërgatitje për misionin:

Lista e dokumentave të bashkangjitura

- Programi i statistikave zyrtare 2013 -2017
- Raportet mbi misionet në Projektin e Binjakëzimit, Komponenti 4 (të gjitha në dispozicion në dst.dk/Kosovo)

Aneksi 1. Programi, - Shtator 2015

Dita	Vendi	Koha	Ngjarja
1	ASK	10:00	Hyrje në këtë pjesë të komponentit 4
		10:15	ASK do të prezantojë gjendjen aktuale të zhvillimit të strategjisë së diseminimit që nga misioni i fundit
		11:00	Pushim për kafe
		11:15	Prezantimi nga ekspertët Dakordimi mbi planin për 2,5 ditë
		12:00	Dreka
		13:30	Diskutimi i dokumentit aktual të Strategjisë së Diseminimit
		14:30	Pushim për kafe
		15:00 – 16:00	Puna rreth dokumentit të Strategjisë së Diseminimit
2	ASK	09:00- 16:00	Puna rreth dokumentit të Strategjisë së Diseminimit
3	ASK (Jesper SC Takimi 09:00- 12:00)	09:00- 16:00	Konkluzionet dhe rekomandimet: Diskutimet se si të zhvillohet strategjia e diseminimit për ASK– mënyra më e mirë përpara Dakordimi i titujve për Strategjinë Autorët Plani kohor Misioni i radhës? Takim mes ekspertëve, udhëheqësit të komponentit dhe RTA
4	ASK	09:00- 12:00	Shkrimi i raportit

Aneksi 2. Personat e takuar

Stafi i ASK-së:

1. Ilir Berisha, Drejtor i DSELLK, ASK, Ilir.t.Berisha@rks-gov.net
2. Ramiz Ulaj, Director of DMTI, ramiz.ulaj@rks-gov.net
3. Ibrahim Rrustemi, Drejtor i DPKK, ASK, Ibrahim.rrustemi@rks-gov.net;
4. Bekim Canolli, Shef i metodologjisë, Bekim.canolli@rks-gov.net
5. Teuta Zyberi, Zyrtare e Lartë për Marrëdhënie me Jashtë, teuta.zyberi@rks-gov.net
6. Znj. Hazbije Qeriqi, Zyrtare për Komunikim, ASK, hazbije.qeriqi@rks-gov.net
7. Znj.Drita Sylejmani, Zyrtare e Diseminimit, Drita.sylejmani@rks-gov.net,
8. Znj. Shqipe Gashi, Zyrtare e Diseminimit, ASK shqipe.gashi@rks-gov.net
9. Z. Burim Limolli, Shef i TI-së - Divizioni, burim.limolli@rks-gov.net
10. Znj. Bedrije Demaj, Zyrtare LFS, ASK Bedrije.Demaj@rks-gov.net,
11. Znj Naime Rexhepi, Statistikat Sociale, ASK Naime.Rexhepi@rks-gov.net

Stafi i Projektit të Binjakëzimit:

Z. Per Knudsen, RTA, pkn@dst.dk

Znj. Nora Zogaj, asistente e RTA, zogaj.nora@gmail.com

Përkthyesi (në disa misione)

Aneksi 3

Titulli i Dokumentit	Përmbajtja	Përgjegjës për draft	Afati kohor për draftin e parë	Afati kohor për aprovim
Strategjia e Diseminimit	Strategjia e përgjithshme – do të përkrahet nga dokumentat më poshtë	Zgjerimi i draftit aktual. Të gjithë ne/ të gjithë në ASK - PKN	Fundi i Tetorit	Fundi i Dhjetorit – Bordi i Drejtorëve
Procesi i Diseminimit të Prodhimit		Përfaqësuesit e diseminimit nga divizionet Burim Limolli & Drita Sylejmani	Fundi i Tetorit	Fundi i Dhjetorit – Bordi i Drejtorëve
Procedurat për azhurnimin e askdata?	Trajnimi / ndryshimet në ndarjen e punës. Të sigurohet që azhurnimi mund të kryhet pa TI.	Kryeshefi ka kërkuar për një grup në takimin e kaluar. Burim Limolli	Numri x i stafit i trajnuar ? Tema e parë i jepet divizionit përkatës. Fundi i Shtatorit	Fundi i Dhjetorit – Bordi i Drejtorëve
Procedurat për azhurnimin dhe shkrimin e metadatave	Përdorimi i metadatave / përshkrimet e cilësisë, në word ose sistem të ri?	Bekim Canolli / Servete Mureqi, përfaqësues të divizioneve s	Puna në vazhdim	
Procedurat për trajtimin e Gabimeve –të Jashtme	Dokument specifik vetëm për gabimet. Çfarë i tregojmë përdoruesve – duhet të paraqitet në strategji	Drita Sylejmani / Hazbije Qeriqi, përfaqësues të divizioneve	Fundi i Tetorit	Fundi i Dhjetorit – Bordi i Drejtorëve
Procedurat për trajtimin e Gabimeve –të Brendshme	Dokument specifik vetëm për gabimet dhe trajtimi i brendshëm	Drita Sylejmani / Shqipe Gashi, përfaqësues të divizioneve	Nëntor 13	Fundi i Dhjetorit – Bordi i Drejtorëve
Politika e Rishikimit	Nevojat dhe formulimi do të diskutohen brenda ASK-së	Ibrahim Rrustemi përfaqësues të divizioneve		

Politika e shtypit dhe mediave (në progres?)	Zhvillimi ka filluar në Qershor nga Projekti i Binjakëzimit (SDP & HHB). Disa mund të merren nga politika e regjistrimit	Hazbije Qeriqi, përfaqësues të divizioneve	Fundi i Nëntorit	Fundi i Dhjetorit – Bordi i Drejtorëve
Udhëzuesit mbi Dizajnit (drafti nga Projekti i Binjakëzimit)	Drafti ka filluar nga Projekti i Binjakëzimit (Rune & Markku)	Drita Sylejmani / Burim Limolli / Hazbije Qeriqi	Në mes të Dhjetorit	
Procedurat mbi konfidencialitetin e të dhënave	?			
Politika e mediave sociale	Nëse, dhe kur, ASK vendos të komentojë dhe të lidhet me përdoruesit e vet në rrjetet sociale			

Aneksi 4

STRATEGJIA E DISEMINIMIT KOSOVË DRAFT ORGANIZATA

ASK-ja vepron mbi bazën e Ligjit mbi Statistikat Zyrtare në Kosovë. Sipas Ligjit, është detyrë e ASK-së të mbledhë dhe publikojë të dhëna mbi ekonominë dhe llogaritë kombëtare, statistikave sociale, bujqësinë dhe statistikave të ambientit në Kosovë.

Strategjia bazohet në praktikën më të mirë evropiane për diseminimin. Parimet e diseminimit zbatohen në Kodin e Praktikës të Statistikave Evropiane. Objektivat kryesore janë

- ASK-ja të jetë burimi i preferuar i fakteve statistikore për Kosovë
- Të ofrohen fakte dhe statistika për debate publike në Kosovë
- Të përmirësohet ndërveprimi / dialogu me përdoruesit

Strategjia e diseminimit do të mbështesë arritjen e këtyre objektivave.

ASK-ja të jetë burimi i preferuar i fakteve statistikore për Kosovë

Të dhëna relevante dhe të besueshme

Diseminimi i statistikave zyrtare duhet të jetë objektiv, neutral, i paanshëm dhe transparent. Diseminimi i statistikave zyrtare është relevant, në kohën e duhur, dhe bazohet në publikime të përpikta.

Mbrojtja e të dhënave është e garantuar kur ASK-ja publikon statistikave. Privatësia dhe identiteti i ofruesve të të dhënave (ekonomistë familjare, ndërmarrjet, administratat dhe të intervistuesit e tjerë) janë konfidenciale dhe të dhënat, që ata ofrojnë, përdoren vetëm për qëllime statistikore.

Njoftimi për gabimet dhe keqpërdorimet

Përdoruesit informohen për gabimet në faqen kryesore të webfaqes. Gjithashtu, informohen abonuesit. Publikohen komunikatat e reja për shtyp. Korrigjimi i gabimeve rregullohet sipas procedurave të shkruara. Këto procedura miratohen nga Bordi Menaxhues i ASK-së.

Gabimet e zbuluara në statistikave të publikuara korrigjohen në webfaqe, sa më shpejt që është e mundur.

Për sa i përket publikimeve në letër, korrigjimet duhet të merren në konsideratë në rast të gabimeve serioze dhe, nëse e mundur, duhet të informohen përdoruesit.

Nëse ka ndonjë keqpërdorim apo keqinterpretim të statistikave në media, ASK-ja duhet të ndërmarrë veprime. Procedurat për veprimet e tilla mund të gjenden në politikën e ASK-së për media dhe shtyp.

Afati kohor & Përpikëria

Njoftimet për diseminimin e statistikave publikohen në kalendarin e publikimit në webfaqe. Kalendarin e publikimit përshkruan temën dhe fushën, periudhën referente dhe datën e publikimit. Çdo devijim nga orari i diseminimit publikohet sa më shpejt që është e mundur, duke dhënë dhe shpjegimet për vonesën, si dhe datën e re të publikimit. Të gjitha publikimet

bëhen në një orë/kohë fikse gjatë ditës (kur? zakonisht ne 10. Do të implementohet nga data 1x 201x).

Devijimet nga afatet kohore dhe përpikëria monitorohen rregullisht dhe, në rast se këto afate nuk respektohen, bëhet një plan veprimi përkatës.

Dokumentimi i saktë (metadat)

Statistikat zyrtare gjithmonë shpërndahen me metadat dhe shpjegimet përkatëse për të evituar keqinterpretimet dhe keqpërdorimet.

Përdoruesit informohen për cilësinë e produkteve statistikore sipas kriterëve të cilësisë të Statistikave Evropiane.

Dokumentimi i metodologjisë përfshin informacionet mbi burimet dhe metodat e mbledhjes së të dhënave, si dhe mbulueshmërinë dhe përkufizimet e përdorura në produktet statistikore. Ato mund të gjenden në webfaqe dhe të gjitha publikimet statistikore dhe tabelat në askData do të kenë vegëzat përkatëse për tek to. Informacionet mbi metodologjinë përpilohen sipas standardeve të Eurostat-it (cilat?)

Krahasueshmëria ndërkombëtare

Statistikat e shpërndara duhet të jenë koherente dhe të krahasueshme, sipas parimeve dhe klasifikimeve ndërkombëtare.

Marketingu / Marrëdhëniet me publikun / Rrjetëzimi

Të gjithë përdoruesit kryesorë janë shënuar nga njësitë prodhuese gjatë procesit të planifikimit. Disa përdorues gjithashtu janë kontaktuar për të marrë mendimet e tyre lidhur me statistika të caktuara. Janë mbledhur edhe informata mbi nevojat dhe propozime për përmirësimin e statistikave për sa i përket mbuleshmërisë dhe cilësisë. **Duhet pak tekst këtu** (ASK-ja duhet të jetë e dukshme dhe burim i besueshëm dhe i preferuari për shfrytëzuesit kryesorë – aktivitetet për të arritur këtë)

Të ofrohen fakte dhe statistika për debate publike në Kosovë

Relevanca dhe afatet kohore

Qasja

Të gjithë përdoruesit duhet të kenë qasje të barabartë të statistikave zyrtare në webfaqe. Kjo do të thotë që datat e diseminimit të statistikave zyrtare duhet të paralajmërohen paraprakisht dhe që asnjë kategori përdoruesish të mos ketë qasje në statistikat përpara se ato të publikohen. ASK-ja publikon statistikat në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze.

Platformat

ASK-ja përdor platforma ose produkte të ndryshme për të arritur tek përdoruesit e vet. Prioritare do të jetë askData dhe diseminimi elektronik në internet. Nga viti **2017?** të gjitha të dhënat do të jenë në dispozicion në askData.

Gazetarët dhe mediat e lajmeve

Shumë përdorues informohen për statistikat vetëm përmes mediave. Prandaj, duhet kushtuar vëmendja e veçantë gazetarëve dhe mediave të lajmeve. Mediat e lajmeve informohen

aktivisht për publikimet e reja relevante statistikore. Përveç kësaj, ASK-ja ndërmerr aktivitete për prezantimin dhe shpjegimin e publikimeve statistikore për shtypin dhe mediat e lajmeve – kur konsiderohet relevante, mbahen konferenca për shtyp dhe takime me mediat.

Ndërveprimet e ASK-së me mediat e lajmeve përshkruhen në politikën e ASK-së për media dhe shtyp.

Kuptueshmëria

ASK-ja siguron që statistikat janë të kuptueshme duke ofruar metadata të standardizuara.

ASK-ja do të sigurojë që përdoruesit, pavarësisht arsimimit dhe profesionit, të gjejnë dhe kuptojnë statistikat, që janë relevante për jetën e tyre të përditshme. Për të arritur këtë qëllim, përdoren vizualizimi dhe tregimet e ngjarjeve.

Platformat relevante (web-i, mediat sociale, masmedia, askData, publikimet në letër).

Disa grupe përdoruesish mund të arrihen përmes mediave sociale. Prandaj, ASK-ja është aktive në disa media sociale.

Vizualizimi

Statistikat vizualizuese shpesh ofrojnë një pasqyrë më të qartë të të dhënave krahasuar me tabelat, tekstet ose databazat. Vizualizimi i të dhënave duhet të bëhet për interes të përdoruesve **GIS?**

Të përmirësohet ndërveprimi / dialogu me përdoruesit

Përdorues të ndryshëm kanë nevojë për lloje të ndryshme statistikash. ASK-ja ofron një numër të madh produktesh dhe shërbimesh.

Përdoruesit ndahen si në vijim (jo sipas prioritetit):

- institucionet qeveritare
- qeveritë lokale
- studentët, hulumtuesit dhe institucionet arsimore
- mediat e lajmeve
- kompanitë
- organizatat joqeveritare, asociacionet, fondacionet etj.
- përdoruesit e jashtëm dhe organizatat ndërkombëtare
- qytetarët e zakonshëm

Njihni përdoruesit tuaj!

Komunikimi me përdoruesit bëhet me qëllim të të kuptuarit të nevojave të tyre. Arritja e përdorimit të lehtë të produkteve bazohet në anketat mbi kënaqshmërinë e përdoruesve.

Monitoroni përdorimin e statistikave dhe kënaqshmërinë e përdoruesve!

Kënaqshmëria e përdoruesve monitorohet rregullisht dhe sistematikisht. Gjithashtu, analizohen të dhënat mbi përdorimin e statistikave.

Komunikoni me përdoruesit dhe mësoni nga ta!

ASK-ja takohet rregullisht me grupe të caktuara përdoruesish për të diskutuar pritshmëritë e tyre për produktet dhe shërbimet. Këto takime mund të shfrytëzohen edhe për të informuar përdoruesit për ndonjë ndryshim të planifikuar të statistikave.

Vetëdijësimi

Organizohen trajnime dhe ngjarje të tjera për të ngritur vetëdijen për ASK-në dhe statistikat në përgjithësi tek studentët, institucionet qeveritare dhe bizneset private.